



**Prishtinë, 10 dhjetor 2020**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1336\_2020**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15, dhe Nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Nenin 8 paragrafët 4, 8 dhe 11 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT Sh.A) të datës 05.10.2020 për shqyrtim dhe aprovim të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021;

**në seancën e mbajtur me datë 10 dhjetor 2020, nxori këtë:**

## **V E N D I M**

**I. APROVOHET - dokumenti Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021**

### **A r s y e t i m**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 05 tetor 2020 ka pranuar kërkesën për aprovim të dokumentit **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021** nga KOSTT Sh.A. ZRRE ka dhënë komentet e veta në formë të shkruar si dhe ka kërkuar sqarime lidhur me çështjet e ngritura në dokument. Pas trajtimit së komenteve, dokumenti është dërguar në ZRRE si version final për aprovim me datë 04 dhjetor 2020.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të dokumentit dhe Bazuar në Nenin 8 të Ligjit për Energjinë, ka vlerësuar se dokumenti i përmbush kërkesat teknike dhe procedurale, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të Vendimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi duke miratuar dokumentin **Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021**.
- II. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë elektrike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.**
- III. Bilanci do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së si dokument unik i ZRRE-së së**



bashku me Bilancin e Energjisë Termike 2021.

- IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku do të publikohet edhe dokumenti i përbashkët si Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike dhe Energjisë Termike.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

- Bilanci Vjetor i Energjisë Elektrike 2021

Vendimi i dërgohet:

- Të licencuarit KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

**Bordi i ZRRE-së,**

  
Arsim Janova, u.d. Kryesues

  
Besim Beqiraj, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar